Kronikë

Drogë, armë e dokumente të falsifikuara, pranga të riut në Durrës! Nën hetim edhe një 40-vjeçar

Një 21-vjeçar ka rënë në prangat e policisë së Durrësit ndërsa një 40-vjeçar do të hetohet në gjendje të lirë pas një operacioni të zvilluar për goditjen e shpërndarjes së lëndëve narkotike dhe armëmbajtjes pa leje.

Foto ilustruese

Redaksia
6 Korrik, 10:49 | **Përditësimi: 6 Korrik, 11:05**

Share

Durrës- Një 21-vjeçar ka rënë në prangat e policisë së Durrësit ndërsa një 40-vjeçar do të hetohet në gjendje të lirë pas një operacioni të zvilluar për goditjen e shpërndarjes së lëndëve narkotike dhe armëmbajtjes pa leje.

Blutë bënë me dije Sentiljano Selami po drejtonte makinën pa patentë ndërsa në banesën tij gjetën 25 doza lëndë narkotike e dyshuar kokainë, 50 doza lëndë narkotike e dyshuar kanabis, 1 armë zjarri pistoletë me numër serie të pjesshëm (i fshirë pjesërisht), 100 fishekë luftarak të kalibrave të ndryshëm, 1 pasaportë biometrike në emër të një shtetasi tjetër dhe 3 telefona celularë.

Arma do të dërgohet për ekzaminim në Institutin e Policisë Shkencore, me qëllim verifikimin nëse është përdorur në ngjarje të mëparshme kriminale.

LEXO EDHE:
KF Teuta 'ndryshon fytyrë', në Durrës prezantohet presidenti i ri! Dobi merr postin e trajnerit, Arapi rikthehet si drejtor sportiv

Ndërkohë sa i përket 40-vjeçarit, efektivët informojnë se ai do të hetohet për mbajtje pa leje të armëve të fthota.

> *"Në vijim të punës për parandalimin, evidentimin dhe goditjen e veprimtarive kriminale, Seksioni për Hetimin e Narkotikëve në DVP Durrës, në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Durrës, finalizoi me sukses operacionin policor të koduar "Mix".*
>
> *Si rezultat i këtij operacioni u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit S. S., 21 vjeç, banues në fshatin Kullë, Manzë, Durrës.*
>
> *Si dhe u procedua penalisht në gjendje të lirë shtetasi Rr. K., 40 vjeç, banues në Kullë, për mbajtje pa leje të armëve të fthota.*
>
> *Operacioni u zhvillua mbi bazën e informacioneve të siguruara në rrugë operative, për një shtetas që dyshohej se shpërndante lëndë narkotike dhe mbante armë zjarri.*
>
> *Gjatë kontrollit të ushtruar në automjetin me të cilin udhëtonte personi i dyshuar, në fshatin Kullë, rezultoi se shtetasi S. S. po drejtonte mjetin pa leje drejtimi;*
>
> *Ndërsa në çantën e shtetasit Rr. K., shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan një mjet prerës (thikë).*
>
> *Në vijim të operacionit, gjatë kontrollit të banesës së shtetasit S. S., në fshatin Kullë, u gjetën dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale:*
>
> *25 doza lëndë narkotike e dyshuar kokainë, 50 doza lëndë narkotike e dyshuar kanabis, 1 armë zjarri pistoletë me numër serie të pjesshëm (i fshirë pjesërisht), 100 fishekë luftarak të kalibrave të ndryshëm, 1 pasaportë biometrike në emër të një shtetasi tjetër dhe 3 telefona celularë*
>
> *Arma e zjarrit do të dërgohet për ekzaminim në Institutin e Policisë Shkencore, me qëllim verifikimin nëse është përdorur në ngjarje të mëparshme kriminale", njoftoi sot policia.*

Materialet iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për veprime të mëtejshme procedurale, për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", "Mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit", "Mbajtja pa të drejtë e armëve të fthota" dhe "Falsifikimi i dokumenteve"

Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: Sentiljano Selami | kanabis | kokaine | armëmbajtje pa leje | Durres

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Nis aksioni për lirimin e hapësirave publike, si e vlerësoni?

5 Korrik, 08:25

Të drejtë | Të gabuar | Aksion i vonuar

Lajme të tjera

Aksioni për lirimin e hapësirave publike/ Policia bën bilancin: 1230 shezlongë e çadra të sekuestruara nga Durrësi në Sarandë! 2 të arrestuar
7 Korrik, 09:01

Rinumërimi u mbyll/ KAS shqyrton ankimimet e PD-së në 4 qarqe! Logu: Të hapen materialet e 300 kutive në Tiranë! Kërkesa i rrëzohet
7 Korrik, 07:51

Shkodër/ Parcelat e mbushura me kanabis, asgjësohen mbi 40 mijë bimë, nën hetim 8 kryepleq dhe 2 roje mjedisi! Kultivuesit ende në kërkim
6 Korrik, 12:22

Drogë dhe prostitucion, arrestohen dy të huaja në Tiranë dhe klienti i tyre shqiptar
6 Korrik, 11:26

Mirditë/ Mbollën në mes të pyllit parcelën me 130 rrënjë kanabisi, shpallen në kërkim 2 vëllezërit!
5 Korrik, 15:58

Me kallash, çifte e pistoletë pa leje në banesë, pranga 50-vjeçarit në Lushnjë (VIDEO)
5 Korrik, 12:47

Erdhën si turiste, dy kinezet bazë prostitucioni në Qerret! Vihen në pranga, mermin pagesa deri në 200 euro (VIDEO)
5 Korrik, 12:28

Mjegulla e dendur 'pushton' Durrësin edhe gjatë natës (VIDEO)
5 Korrik, 07:38

Itali/ Lëvizte i qetë nëpër qytet me kokainë në xhepa, 33-vjeçari shqiptar arrestohet përsëri nga karabinierët
4 Korrik, 17:58

Tepelenë/ 'Koordinata' zbulon dy parcela me 195 rrënjë hashashi në Progonat e Mamaj, nën akuzë edhe një nga kryepleqtë! Hetime për autorët
4 Korrik, 13:37

VIDEOLAJM/ Mjegulla e madhe 'pushton' bregdetin e Durrësit dhe të Vlorës
4 Korrik, 13:16

VIDEO/ Kapen tre tonë kokainë në Ekuador, autoritetet vendase: I përkiste mafias shqiptare! Pesë në pranga
4 Korrik, 10:24

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje